



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Drejtoria për Inspektion
Nr. 10 ____/2025`

Datë/Data	08.01.2025
Për/To/Za	Bashkim RAMOSAJ- kryetar i Komunës
Nga/from/Od	Ajne Iberhysaj- U.D Shefe Inspektionit
Tema/Subject/Subjekat	RAPORT I PUNËS PËR PERIUDHEN JANAR-DHJETOR 2024

Drejtoria për Inspekcione gjate gjashtëmujorit të parë të vitit kalendarik 2024 kanë kryer punët dhe detyrat e punës të mbështetur në Ligjet, aktet nënligjorë, rregulloreve komunale me të cilat rregullohet puna e inspektorëve sipas fushave përkatëse, duke ju përmbajtur Planit të punës së Drejtoratit për vitin 2024.

Në Kuadër të drejtorisë për Inspektion janë sistemuar këta zyrtar:

Inspektori i Tregut,
Inspektori i Mbrojtjes së Mjedisit që njëkohësisht është edhe shefe e inspektorëve
Inspektori i Ndërtimit (me Kontratë mbi shërbimet e Veçanta),
Inspektori i Veterinës (i angazhuar me kontratë mbi shërbimet e veçanta) dhe
Zyrtarja Administrativë

Inspektorët përkatës sipas profesioneve të tyre kanë vepruar duke kryer inspektime(kontrolle mbikëqyrjeje) ndaj veprimtarive tregtare, ekonomike, ndërtimit, në fushën e mjedisit, afatizimin e prodhimeve bujqësore si nga produktet qumështit dhe me prejardhjen e tyre. Në ruajtën e dhe mbrojtjen e shëndetit publik, në ushtrimin e veprimtarive sipas inspektorëve në pajtim me kërkesat në pajtueshmëri me legjislacionin e Republikës së Kosovës;

Drejtoria e Inspektionit ka kryer inspektime të përbashkët me: Stacionin e Policisë, Komisionin për Miniera dhe Minerale, me Inspektoratin e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës koordinim dhe bashkëpunim me drejtoritë e komunës ku këto inspektime kanë pasur për qëllim racionalizimin dhe koordinimin e veprimeve inspektuese të përbashkëta.

Gjithashtu inspektimet e planifikuara – janë inspektimet të realizuara sipas planit të punës dhe planit të monitorimit; Inspektimi i paplanifikuar ka përfshirë edhe procesin e inspektimeve i cili

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN

Drej. Inspektionit 758

02 09.01.25

DEÇAN DEÇANE

paraqitet ad-hoc dhe sipas nevojës pozitës zyrtare profesionale të inspektorit; po duke u bazuar edhe në kërkesat e parashtruar. Gjithashtu, janë krye edhe inspektimi sipas kërkesave të personave fizik dhe juridik – janë inspektime të realizuara në bazë të paraqitjes së kërkesave në intranet;

Ri-inspektimi – është inspektimi përcjellës që kryhet gjatë dhe pas kalimit të afatit të caktuar nga inspektori lidhur me përmbushjen e urdhrit apo kërkesave për eliminimin e parregullsive të konstatuara gjatë inspektimit;

Këshilla inspektuese të subjektit të inspektuar për zbatimin sa më korrekt të legjislacionit në fuqi dhe eliminimit të gjeturave subjekti inspektues si dhe marrjen e masave administrative dhe shqiptimit të gjobave që kanë për qëllim shmangien e rreziqeve që mund t'i shkaktohen shëndetit publik, sigurisë publike dhe interesave të ligjshme të personave fizikë dhe juridikë, të përcaktuara nga ligjet apo me ligje të veçanta.

Janë marr veprime për shkeljet serioze duke i veçuar ndërtimet në kundërshtim me ligjet në fuqi dhe kushtet urbanistike të lëshuara nga Drejtoria për Urbanizëm, ndërtim dhe mbrojtje të mjedisit po ashtu edhe mbi ndërtime pa leje të ndërtimit duke ndërmarr edhe ngritjen e kallëzimeve penale.

Në kuadër të drejtorisë janë marr masa administrative nga zyrtarja administrative që ka qenë përgjegjëse për lëshimin e fletëpagesave, taksave administrative, gjobave mandatorë përmes sistemit të Intranetit varësisht prej Ligjeve, Udhëzimeve Administrative dhe Rregullores Komunale në secilën fushë përkatëse të inspektimit. Duhet të theksohet edhe se janë kryer edhe punë tjera sipas fushe veprimtarisë të secilit nga inspektorët. Në tabelën në vijim po e prezantojmë aktivitetin e inspektorëve: **Tabela 1**

Pozita zyrtare	Inspekti me në teren sipas detyrës zyrtare	Inspektime sipas kërkesë-personave fizik dhe juridik	Aktivendime	Gjoha mandatorë	Inspektime për leje të ndërtimit	Inspektime për leje mjedisore	Kërkesa për gjykatë
Inspektorja për mbrojtje të mjedisit	55	137	21	20	19	12	6
Inspektori i tregut	88						
Zyrtarja administrative (asistime)	76						
Inspektori i ndërtimit	52						
Inspektori i Veterinarisë	37						
Gjithsej	308	137	21	20	19	12	6

Kërkesë: Si çështje e ndjeshme që është ndërtimi dhe cilësia e ushqimit (produkteve të qumështit dhe mishit) zgjidhja e çështja e inspektorëve të ndërtimit dhe veterinarisë është e domosdoshme.